Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT



1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 1/1;*
- c. Deklaratëmbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Kriteret Ligjore referuar shtojcës 11, pika 1 "Kritere të Përgjithshme të Pranimit të Kualifikimit".

**2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. OE duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) të paraqitura në autoritetet përkatëse.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/ për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2017, 2018, 2019) e cila duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 2 200 000 leke.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019, të Bashkisë ku ka ushtruar aktivitetin për vitin 2019.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrative ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR).*

**2.3 Për kapacitetin teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme për një objekt të vetëm të realizuar gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 1 140 000 leke.

Ose

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të kryera të marra së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë në një vlerë jo më të vogël se

4 500 000 leke.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e

dokumentat e mëposhtme:

- a. Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontratë
  - Faturat tatimore të shitjes të cilat do të përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH
- b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Faturat tatimore të shitjes të cilat do të përmbajnë (datën, shumën si dhe sasinë e mallrave të furnizuar) me TVSH

2. Një punësim mesatar i të paktën 30 (tridhjetë) personave, për periudhën Qershor 2019 – qershor 2020, të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Qershor 2019 – qershor 2020.

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2019 – qershor 2020.

3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) inxhinier druri dhe 1 (një) Arkitekt, të vërtetuar me diplomë, CV dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të investimit) si dhe të rezultojë në listpagesa për tre muajt e fundit.

4. Subjekti ofertues duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit, sipas të cilës gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

5. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësise:

- 1) Certifikatën e cilësise së punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme, e akredituar)
- 2) Certifikatë ISO 28001:2007 (e vlefshme, e akredituar).
- 3) certifikatë ISO 22301:2012 (e vlefshme, e akredituar)
- 4) Certifikatë “Për sistemin e integruar të menaxhimit”BS PAS 99:2012 (e vlefshme, e akredituar)
- 5) certificate ISO 3834-2006(e vlefshme, e akredituar)

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e cilësisë të mësipërme sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër për këtë procedurë prokurimi.*

6. Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 ( dy) mjete transporti me kapacitet mbajtes nga 1 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit duhet të shoqërohet me kontraten perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- c) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet të deklaruara*
- d) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi)*

7. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim/leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit përkatës kur ofertuesi është prodhues. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë secili duhet të disponojë autorizimin/lejen mjedisore.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë mallrave në adresat e autorizuara nga AK. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzohen do të jenë sipas specifikimeve teknike.

9. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e

hapjes së ofertave pranë AK. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST, të jenë:

*RAFT Zyre cope 1*

*Karrike rrotulluese specialist cope 1*

*MDF rimeso Lisi pllake 80\*60 cm cope 1*

*Karrike fikse cope 1*

*Element per veshje muri 80\*60 cope 1*

*Mosparaqitja e mostrave dhe në përputhje me specifikimet teknike në ditën e hapjes së ofertave, është kusht skualifikues. Operatori Ekonomik fitues do t'i mbahen mostrat deri në realizimin e kontratës ndërsa operatorëve ekonomikë jo fitues do tu kthehen mostrat e depozituara, brenda 5 (pesë) ditëve nga adat e vlerësimit përfundimtar të procedurës.*

10. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.

*II. Rastet e detyrimeve te meparshme kundrejt Bashkise Roskovec si : gjoba, debi te ndryshme, moszbatim ne kohe dhe sipas kushteve perkatese te kontratave te meparshme, te dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, do te perbejne kusht per s'kualifikim te operatorit/operatoreve ekonomik perkates.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 12**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrim i punëve :

Grafiku i Punimeve:

---

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

I- Keshilli Bashkiak

1-Tavoline PODIUMI 240\*80\*75 cm.Struktura dhe syprina material drusor Mdf me trashesi 4cm ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë.Aksesorët të jenë cilësorë Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .



2-Tavoline PODIUMI 160\*80\*75 cm.

Struktura dhe syprina material drusor Mdf me trashesi 4cm ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .

3-Tavoline specialistesh PODIUMI 120\*80\*75 cm.

Struktura dhe syprina material drusor Mdf me trashesi 4cm ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .

4-Tavolina salle

Tavolinat shtrihen ne menyre harmonike sipas renderit. Struktura dhe syprina material drusor Mdf ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Pjesët anësore të jenë prej të njëjtit material si suprina .Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .



#### 5-Foltore 80 x 60 x 125 cm

Materiali i përdorur MDF ose Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Fianket (Faqet anësore) bashkohen me pjesën ballore në formë U. Plani i leximit vendoset në mënyrë të tillë që bordet e sipërme të fiankeve (faqeve anësore) dhe ballores të jenë 7 cm më lart. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Në pjesën e poshtme të fiankeve (faqeve anësore) të montohen këmbëza niveluese. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.

#### 6-Veshje Muri

Veshja te jete material drusor mdf ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave jo me pak se 16mm. Montimi te jete I tille qe te garantoj pamje solide dhe aksesore te padukshem.Kornizimi te jete me mdf jo me pak se 16 mmm dhe te ruhet lineariteti si ne render per ti dhene pamje solide dhe komforte. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .





## 7-Karrike salle

Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë të ndërtuara me materiale të buta që gjatë përdorimit të marrin formën e trupit duke siguruar në këtë mënyrë një qëndrim të rehatshëm kur përdoren për një kohë të gjatë. Dimensionet e karriges janë: ndenjësja 45-47 x 49-52 cm gjerësi, shpinorja 45-47 x 41-48 cm, lartësia e karriges 77-94 cm, dhe lartësia e ndenjësës 44 - 46 cm. I gjithë materiali i butë është i instaluar në strukturën mbajtëse të ndenjësës dhe i mbuluar me material veshës. Mbështetësja e shpinës duhet të jetë e pajisur me elemente që sigurojnë një ndenjje komforte dhe njëkohësisht janë pjesë e integruar e dizajnit të vetë ndenjësës.

### - ***Komponentët e ndenjësës***

E gjithë njësi ulësedhembështetëseduhet të mbështetet nënjë strukturë metalike që është e fiksuar në dysheme dhe është statike, e palëvizshme (si ndenjëset e teatrit).

Pjesaepasme embështetësës duhet të jetë veshur me të njëjtin material që është veshur edhe pjesa tjetër e ndenjësës duke siguruar kështu një pamje estetike edhe nga shikuesit prapa.

Ndenjësja duhet të ketë mekanizmin e mbylljes në rastet kur nuk ulet person në të.

### - ***Mbështetëset e krahëve***

Mbështetëset e krahëve duhet të jenë elegante dhe të sigurojnë një komfort gjatë përdorimit.

Ndenjëset do të jenë me krahë anësore, të mbushur.

Struktura mbajtëse do të jetë druri të spesorëve të ndryshëm ose plastike e derdhur në formë anatomike. Për të siguruar qëndrueshmërinë statike të ndenjësëve skeleti mund të jenë metalike, (çelike ose duralumin) por në çdo rast duke mos cenuar pamjen estetike të saj. Materiali veshës i ndenjësës duhet të jetë poliprepilen plastik me dendësi

të lartë që të sigurojnë durueshmëri ndaj veprimeve mekanike dhe mos të deformohet ose copë të kategorisë së parë, rezistente ndaj zjarrit, sipas kërkesës së investitorit. Modeli, materialet dhe



ngjyrat e çdo tipi ndenjësje aprovohet një herë nga investitori dhe me pas vendoset në vepër.

Karriget duhet të jenë të lidhura në sistem dysh ose tresh sipas konfigurimit dhe hapsirës ku do të vendosen.

Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit



## 8-Karrike podiumi

Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore. Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik ose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremitet e tyre.



#### 9-Karrike specialistesh podiumi

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike

#### 10-Karrike pritje publiku

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike

### II- SALLA E MBLEDHJEVE

1-Tavoline e madhe mbledhjeve per 20 Persona.540\*200\*75 Syprina melaminë me trashësi jo me pak 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 320 x 70 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 20 cm midis tyre, dy elementët e tjerë janë në përmasa 110 x 150 cm. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në

një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## 2- Karrike sigma

Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Të ketë krahë anësore. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq i kromuar, i cili përshkon shpinën në dy anët e saj, ndenjësen dhe zbret në tokë duke u mbyllur në formë U, duke luajtur dhe rolin e bazamentit Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat e tapicerisë janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## 3-Karrike fiks

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skeleton metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike

## 7-Veshje Muri

Veshja te jete material drusor mdf ose Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave jo me pak se 16mm. Montimi te jete I tille qe te garantoj pamje solide dhe aksesore te padukshem.Kornizimi te jete me mdf jo me pak se 16 mmm dhe te ruhet lineariteti si ne render per ti dhene pamje solide dhe komforte. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra do të vendoset në momentin e lidhjes së kontratës.Montimi do të kryhet në ambientet e Bashkise Roskovec .

## KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

## Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### PREVENTIVAT E PUNIMEVE

**Objekti: "Mobilimi i dy sallave të bashkisë", (montim mobiljesh, veshje muri etj.)"**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
	<b>A.Mobilimi i sallës së keshillit të bashkisë</b>		
1	Tavoline podium	cope	1
2	Tavoline podium	cope	1
3	Tavoline salle	ml	22,5
4	Foltore	cope	1
5	Badiskop + ele mdf per shkalle	ml	55
6	Tavoline podium specialistesh	cope	1
7	Veshje muri	m2	60
8	Karrike salle	cope	28
9	Karrike Podiumi	cope	4
10	Karrike specialistesh podiumi	cope	3
11	Karrike pritje publiku	cope	10
	Shuma A		
	<b>B.Mobilimi i salles se mbledhjes se administrates te bashkisë</b>		
1	Tavoline e madhe mbledhje per 20 vende	cope	1
2	Karrike sigma	cope	20
3	Karrike fikse	cope	20
	Shuma B		

	Shuma A+B		
	TVSH 20%		
	TOTALI		

## Shtojca 14.

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

## Shtojca 15

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 17

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e

plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e

instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe

të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

#### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

#### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

#### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

## **Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

## **Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

## **Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

## **Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

## **Neni 21: Kontrolli i Cilësisë**

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

